

*Procesverbali i zbardhur i seancës së  
shortit për caktimin e ekspertëve kontabël  
Dt. 7.03.2024*

7.03.2024  
Ora 11:04

***RENDI I DITËS***

**Hedhja e shortit për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 4 subjekte zgjedhore” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023.**

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ:** Z. Ylli MERKAJ, Z. Kristi PULERI
- **Të tjerë:** S’ka

**Z. Y. Merkaaj:** Përshëndetje të gjithëve!

Sot në datën 7 mars 2024 zhvillohet shorti për caktimin e audituesve ligjorë për auditimin e partive politike dhe subjekteve zgjedhore për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në udhëzimin nr.14, dt. 9 qershor 2021, ka përcaktuar kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore e kandidatëve të tyre në fushatën zgjedhore. Në zbatim të këtij udhëzimi është bërë njoftimi publik në faqen zyrtare të KQZ-së për pjesëmarrje të të gjithë aplikantëve të cilët shfaqin interes për të qenë ekspert kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 si dhe zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në Bashkinë Kukës, të datës 24 shtator 2023. Pas zhvillimit të procedurës së shortit me Vendimin me nr. 825, datë 13.12.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka caktuar dymbëdhjetë ekspertët kontabël të licensuar si dhe subjektet zgjedhore që do auditohen nga secili prej tyre.

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës së  
shortit për caktimin e ekspertëve kontabël*

*Dt. 7.03.2024*

Me datë 29.2.2024, ekspertja kontabël e licensuar, zonja Hidajete Kraja, për arsye shëndetësore ka dhënë dorëheqjen. Për këtë arsye, sot në datë 7.03.2024, do të hedhim shortin ndërmjet 11 ekspertëve kontabël për auditimin e katër subjekteve zgjedhore dhe konkretisht:

“Partia Lëvizja e Legalitetit”;

“Bashkimi Liberal Demokrat”;

“Partia Kristian Demokrate” dhe

“Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare”, të cilat duhet të auditoheshin nga zonja Kraja.

Procedura e shortit është si më poshtë:

Në një enë transparente vendosen katër shirita me emrat e subjekteve zgjedhore të cilat futen në gogla me peshë dhe ngjyrë të njejtë. Në enën tjetër transparente vendosen emrat e njëmbëdhjetë ekspertëve dhe këto shirita do të futen në gogla me ngjyrë, peshë dhe formë të njejtë.

Tek ena e parë transparente janë vendosur emrat e katër partive politike:

- “Partia Lëvizja e Legalitetit”;

- “Partia Bashkimi Liberal Demokrat”;

- “Partia Kristian Demokrate” dhe

- “Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare”. Vazhdojmë me enën e dytë transparente ku janë emrat e ekspertëve:

1. Lejla Shahu

7. Eneida Rahmani

2. Sherife Hoxha

8. Shkëlzen Margjeka

3. Meri Lika

9. Neshat Maze

4. Erjon Saraçi


10. Fatmira Kastrati

5. Enkelejda Alite

11. Silvana Gjikhima

6. Anida Nuri

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës së  
shortit për caktimin e ekspertëve kontabël  
Dt. 7.03.2024*

Në enën e parë transparente që janë emrat e subjekteve zgjedhore do të tërhiqet gogla e parë nga një përfaqësues i KQZ-së,

- “Partia Bashkimi Liberal Demokrat”, në enën e dytë do të tërhiqet gogla për të caktuar ekspertin që do të auditojë fondet e kësaj partie. - Ekspertia Lejla Shahu.

Vazhdojmë përsëri në enën e parë transparente që janë emrat e subjekteve zgjedhore tërhiqet gogla për të përcaktuar subjektin zgjedhor që do të auditohet dhe është:

- “Partia Kristian Demokrate”, në enën e dytë do të tërhiqet gogla për të caktuar ekspertin që do të auditojë fondet e kësaj partie. - Ekspertia Meri Lika.

Në enën e parë transparente që janë emrat e subjekteve zgjedhore tërhiqet gogla për të përcaktuar subjektin zgjedhor që do të auditohet dhe është:

- “Partia Lëvizja e Legalitetit”, në enën e dytë do të tërhiqet gogla për të caktuar ekspertin që do të auditojë fondet e kësaj partie. - Ekspertia Eneida Rahmani.

Subjekti zgjedhor i fundit që do të auditohet është:

- “Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare”, që do të auditohet nga eksperti që do të dalë nga përzgjedhja në enën e dytë transparente dhe është eksperti Erjon Saraçi.

Në përfundim të shortit të hedhur në datën 7 mars 2024, eksperti që do të auditojë fondet e “Partisë Bashkimi Demokrat Liberal”, do të jetë zonja Lejla Shahu.

Eksperti që do të auditojë fondet e “Partisë Kristian Demokrate”, do të jetë zonja Meri Lika.

Eksperti që do të auditojë fondet e “Partisë Lëvizja Legalitetit”, do të jetë zonja Eneida Rahmani dhe,

Eksperti që do të auditojë fondet e “Partisë Lëvizja Punëtore Shqiptare”, do të jetë zoti Erjon Saraçi, ju faleminderit!

**Vendimi nr. 29**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

